



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada - Government

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural
Development***

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenin 6 paragrafi 6.4 Ligji Nr. 02/L-8 për Verërat 14 tetor 2005, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 24/2008
**për regjistrat e brendshëm dhe të jashtëm të ndërmarrjeve prodhuese, rrushit,
verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen përmbajtja, forma dhe procedurat e mbajtjes së shënimeve në librin e evidencës së brendshme të kompanisë.

Neni 2

Çdo prodhues i rrushit, verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi është i obliguar të mbajë shënimet në regjistrin e brendshëm të kompanisë.

Neni 3

Prodhuesit e rrushit, verës dhe prodhimeve tjera, janë të obliguar që prodhimtarinë ta deklarojnë një herë brenda vitit:

- a) për prodhimin e rrushit deri më 10 dhjetor të vitit aktual, sipas Aneksit I të këtij udhëzimi administrativ,
- b) për projeksionin e prodhimit për verëra cilësore dhe kulminante me prejardhje të mbrojtur gjeografike më së largu deri më 15 janar të vitit vijues sipas Aneksit II të këtij udhëzimi administrativ,
- c) që deri më 31 korrik të vitit vijues të deklaroj stoqet e verës dhe prodhimeve tjera sipas Aneksit III të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 4

Prodhuesi, përpunuesi dhe tregtuesi i rrushit, verës dhe prodhimeve tjera nga ato janë të obliguar që të dhënat nga regjistri i brendshëm i kompanisë, t'ia paraqes inspektorit fitosanitar nëse kur ato kërkohen nga ai.

Neni 5

Përmbajtja e regjistrit të brendshëm të kompanisë prodhuese, përpunuese dhe tregtuese

Regjistri duhet të përmbajë këto të dhëna për subjektet prodhues për:

1.1 personin juridik:

- a) emrin e subjektit,
- b) selia,
- c) komuna,
- d) numrin identifikues të ndërmarrjes.

1.2 personin fizik

- a) emrin, emrin e babës mbiemrin,
- b) vendlindjen,
- c) profesionin dhe emrin e mbikëqyrësit profesional,
- d) numrin identifikues të ndërmarrjes.

Neni 6

Shënimet për sasinë e verës së prodhuar, sipas varieteteve të rrushit dhe parametrat kimik do të paraqiten nëpër faza në formë tabelore të përcaktuara sipas Aneksit IV të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 7

7.1 Shënimet për prodhimin e verës duhet të përmbajnë edhe pasqyrën tabelare për secilin tank të secilit varietet gjatë procesit të fermentimit që paraqitet në mënyrë tabelare sipas ditëve:

- a) zërthimi i sheqerit,
- b) temperatura e mushtit.

7.2 Për prodhimin e verërave kulminante duhet të përcillen dhe të mbahen shënimet për të gjitha operacionet agroteknike, prej fillimit të vegetacionit e deri në mbarim të tij.

Neni 8

Regjistri i brendshëm duhet të përmbajë edhe shënimet për përdorimin e tharreve, enzimave dhe mjeteve kthjelluese si dhe substancave tjera bioteknologjike për prodhimin e verës.

Neni 9

9.1 Në regjistrin e brendshëm, bodrumet duhet të paraqesin shënimet për operacionet e mbushjes së verës.

9.2 Në librin e shisheve duhet të paraqitet ngarkesa që i bëhet mbushtorës, sipas llojit të verës, sasia në litra, vëllimi, shishet e mbushura, shishet e dëmtuara, asgjësimi i tyre, humbja e verës, numri i shisheve të mbushura që ngarkohet depoja të përcaktuara sipas Aneksit V të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 10

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit Nr.02/L-8 për Verëra të dt. 14 tetor 2005.

Neni 11

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë Anekset I, II, III, IV, dhe V.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, _____2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri,
Idriz Vehapi
